



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 511/9 Prot.

Tiranë më, 23/09/2016

V E N D I M

Nr.112, Datë 23/09/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË KURBIN "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare*", të ushtruar në Bashkinë Kurbin dhe Njësitë Administrative Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe, për periudhën nga data 01.01.2014 deri më datë 31.12.2015.

II. Të miratoj Rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

I. Gjetje nga auditimi: Për të dy vitet objekt auditimi Bashkia Kurbin referuar përgjigjeve të bëra në pyetësor në drejtim të vendosjes së objektivave ka pohuar se nuk ka deklaratë të miratuar të misionit dhe vizionit në përputhje me kërkesat e ligjit për MFK pasi ky aspekt është vlerësuar në nivelin 1. Gjithashtu për sa i përket Etikës personale dhe profesionale, rezulton se nuk ka një rregullore ku të përfshihen raportet punëdhënës-punëmarrës. Rregullorja në fuqi e viti 2012, nuk ka të përcaktuar misionin e kësaj njësie vendore, i mungon përcaktimi i formës dhe mënyrës së komunikimit si asaj verbale ashtu dhe asaj shkresore si dhe me rrjet

elektronik, metoda e llogaridhënies, procedura në lidhje me administrimin, komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, procedurat e sinjalizimit të gabimeve, mashtrimit dhe parregullsive, delegimit të detyrave, rregullave të hyrjes në bashki, masave të sigurisë etj.

1.1 Rekomandim: Për shkak të ndryshimeve thelbësore që kanë pësuar NJQV, do të jetë e nevojshme një mënyrë e re organizimit të strukturave drejtuese dhe ndarjes së përgjegjësisë, për shkak të futjes së përgjegjshmërisë menaxheriale. Për implementimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit gjatë vitit 2016 e në vazhdim, **rekomandojmë:**

Hartimin e deklaratës së vizionit dhe misionit si dhe objektivave themelore të punës dhe përgatitjen urgjentisht të rregullores të brendshme, të procedurave dhe udhëzimeve përfshirë përshkrimet e punës, raportet punëdhënës-punëmarrës duke mbajtur në konsideratë përcaktimin e formës dhe mënyrës së komunikimit, metodën e llogaridhënies, procedura në lidhje me administrimin, komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, procedurat e sinjalizimit, delegimit të detyrave, masave të sigurisë etj.

Brenda vitit 2016

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kurbin nuk ka kodin/rregulloren e vet të etikës në përputhje me legjislacionin në fuqi por edhe me veprimtarinë specifike të tij si dhe nuk kishte në plan të hartonte një të tillë. Përsa i përket kodit të etikës, nga menaxherët nuk ishin përcaktuar procedura për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e raportuara as në rregulloren e Bashkisë në të cilën nuk ishin përfshirë element të rregullave të etikës e të konfliktit të interesit.

2.1 Rekomandim: Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohet nga titullari në një Kod të brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje. Ndërsa përgjegjësia e menaxherëve qëndron në vendosjen dhe komunikimin e vlerave të etikës, përgjegjësia e gjithsecilit qëndron në demonstrimin e integritetit. Përsa lart rekomandojmë hartimin urgjentisht të Kodit të etikës për Bashkinë Kurbin.

Brenda vitit 2016

3. Gjetje nga auditimi: Në fushën e menaxhimit të riskut procesi nuk kishte nisur procesi i analizës së riskut dhe nuk ishte hartuar regjistri i riskut. Gjithashtu nuk kishte procedura të shkruara për menaxhimin e riskut, identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve të cilat mund të venë në rrezik arritjen e objektivave të Bashkisë. Nuk ekzistonin procedura ku nëpunësit autorizues, gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tyre, të kishin deleguar disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, të punonjësit e nivelit menaxherial në varësi direkt.

3.1 Rekomandim: Strukturat e menaxhimit duhet të jenë të ndërtuara për të bërë të mundur arritjen e objektivave të politikës në mënyrë eficiente, në përputhje me standardet specifike dhe me afatin kohor të përcaktuar. Këto struktura duhet të koordinojnë punën për vendosjen e procesit të identifikimit dhe analizës së riskut, që përfshin objektivat specifike të njësisë dhe monitorimin e performancës. Gjithashtu strukturat e menaxhimit duhet urgjentisht të ngrëjë Grupin e Menaxhimit Strategjik GMS dhe të përcaktojnë koordinatorin e riskut si dhe nga menaxherët duhet të merren masat e duhura paraprake për të pakësuar nivelin e riskut për punonjësit që janë përfshirë në detyra me natyrë delikate me qëllim kufizimin e ushtrimit të influencave të dëmshme dhe të pasojave të tyre negative.

Brenda vitit 2016

4. Gjetje nga auditimi: Nuk ka të miratuar një plan afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditimit për procedurat specifike të institucionit bazuar në kërkesat e Kreut III të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. Për trajnimin e stafit në Bashkinë Kurbin, praktika e burimeve njerëzore nuk ishte e tillë që të garantonte

zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit pasi në këtë sektor nuk kishte programe specifike trajnimi si brenda dhe jashtë vendit, nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare.

4.1 Rekomandim: Është përgjegjësi e Titullarit miratimi dhe vënia në funksionim e sistemeve të informacionit dhe komunikimit duke ngritur një sistem për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

4.2 Rekomandim: Për ti shërbyer zhvillimit të mëtejshëm të Burimeve Njerëzore, duhet të hartohen dhe zhvillohen urgjentisht kurrikulat e trajnimit të shoqëruara me propozimet për trajnime të përshtatshme, duke patur parasysh nevojat e njësisë dhe punonjësve të saj.

Brenda vitit 2016

5. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin nuk kishte hartuar kalendarin e përgatitjes së PBA-së, nuk kishte miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA për çdo program. Gjithashtu nga Bashkia Kurbin, projekt-buxheti përfundimtar është dorëzuar për miratim në Këshillin Bashkiak jashtë afateve të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”.

5.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kurbin duhet të paraqesë pranë Këshillit të Bashkisë për miratim dokumentin e PBA-së 2015-2017 dhe duhet të dërgojë në MF, me shkrim dhe në rrugë elektronike, Parashikimin e të ardhurave për periudhën afatmesme dhe parashikimin e shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën afatmesme, të shoqëruar me një relacion për mënyrën e llogaritjes së PBA-së. Kryetari i Bashkisë Kurbin, brenda muajit Nëntor të vitit buxhetor duhet të paraqesë për miratim projektbuxhetin në Këshillin Bashkiak dhe ky i fundit brenda datës 31 Dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vendor.

Brenda vitit 2016

6. Gjetje nga auditimi: Edhe pse e kanë detyrim ligjor, bazuar në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet shoqërore” i ndryshuar dhe VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike” i ndryshuar, sektori i ndihmës ekonomike në Bashkinë Kurbin, nuk kishte marrë informacionin e duhur në lidhje me:

-Regjistrimin e familjeve apo anëtarëve të tyre si subjekte private të regjistruara në organet tatimore;

-Zotërimin e pronësive të pasurive të paluajtshme nga kërkuesit e NE, dokumentacion që vihet në dispozicion nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

-Regjistrimin pranë seksionit të Urbanistikës, tregut të lire, transportit etj. të bashkisë Kurbin e kërkuesve për NE.

6.1 Rekomandim: Meqenëse në Bashkinë Kurbin, procesi i verifikimit për vlerësimin social ekonomik të gjendjes së familjes apo të anëtarëve të saj ka qenë jo i plotë, urgjentisht Sektori i Ndhimës ekonomike në këtë Bashki duhet të vlerësojë gjendjen social-ekonomike të të gjithë familjeve apo anëtarëve të saj të cilët kanë përfituar NE dhe vazhdojnë të jenë në skemën e NE pasi Administratorët shoqëror.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Kërkesat për ndihmë ekonomike nuk nënshkruheshin nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes, në kundërshtim me VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike” dhe në to nuk

deklarohej personi madhor që do të administronte paratë në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 96, datë 07.02.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 787, datë 14.12.2006”;

-Në dosje administroheshin vërtetimet si punëkërkues të papunë për një anëtar të familjes dhe jo për të gjithë anëtarët e familjes të aftë për punë që kishin aplikuar për ndihmë ekonomike, në kundërshtim me pikën 2/dh të VKM nr. 787, datë 14.12.2005;

-Në të gjitha dosjet mungonte verifikimi i gjendjes shoqërore ekonomike të familjes në nevojë kur ka hyrë për herë të parë në skemë ose verifikimi është kryer pas hyrjes në skemë;

-Me përjashtim të disa rasteve të pakta në të shumtën e rasteve mungonte Formulari i vizitës në familje 2 herë në vit, në kundërshtim me nenin 31/b të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005;

-Nga auditimi i dosjeve të binte në sy moshja e re e përfituesve të NE dhe përfitimi i tyre mbi tre vjet NE.

7.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin në të ardhmen të ndjekë të gjitha hapat e nevojshme që i njeh legjislacioni në fuqi për plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e sipërcituar. Gjithashtu për shkak të moshës së re të një pjese të madhe të përfituesve me qëllim punësimin e kësaj gjenerate të re me punë dhe shërbime në komunitet duke i integruar në këtë mënyrë në shoqëri, Bashkia Kurbin duhet sa më parë të hartojë politika të konkretizuara në formën e projekteve për punët e komunitetit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Referuar Dosjes me nr. 2257 me përfitues [REDAKTUAR], kanë rezultuar mangësi si: Mungonte verifikimi i gjendjes shoqërore ekonomike të familjes në nevojë kur ka hyrë për herë të parë në skemë në vitin 2014; Vërtetimet e DAR Tiranë për vitin 2014 të datës 20.10.2014 dhe dy vërtetimet për vitin 2015 të datës 09.11.2015, vërtetojnë se dy fëmijët pjesëtarë të familjes janë nxënës në shkollën nëntëvjeçare “28 Nëntori” në Tiranë, ndërsa Vërtetimi i DAR Tiranë i datës 12.10.2015 vërteton se edhe bashkëshortja [REDAKTUAR], është duke vazhduar gjimnazin “Kostandin Kristoforidhi” Tiranë; Mungojnë deklaratat e paraqitjes mujore për muajt Prill, Korrik, Tetor, Nëntor, Dhjetor për vitin 2014, ndërsa deklaratat e paraqitjes mujore për muajt Shkurt, Mars dhe Prill 2015 janë pa firmën e administratorit; Në dosje janë 6 deklaratat mujore me firmat e kërkuesve por pa firmosur nga administratori shoqëror. Nga sa më lart rezulton se familja është në Tiranë dhe nuk banon në Kurbin.

8.1 Rekomandim: Të studiohet dhe verifikohet rasti i familjes [REDAKTUAR], pasi nga të dhënat e administruara në dosje nuk i takon NE dhe si rrjedhojë nga Bashkia Kurbin të merren masat për nxjerrjen nga skema e përfitimit të Ndihmës Ekonomike.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Për mënyrën e organizimit dhe të veprimtarisë, Ndërmarrja Mirëmbajtjes së Rrugë-Kanalizimeve nuk kishte një rregullore të funksionimit të saj ku të përfshiheshin misioni dhe vizioni, raportet punëdhënës-punëmarrës në nivel drejtori, përgjegjësi sektori dhe specialisti (përshkrimet e punës së gjithsecilit), kriteret e vlerësimit të punës, përcaktimi i formës dhe mënyrës së komunikimit, metoda e llogaridhënies, procedura në lidhje me administrimin, komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, procedurat e sinjalizimit të gabimeve, mashtrimit dhe parregullsive, delegimit të detyrave, masave të sigurisë etj.

9.1 Rekomandim: Titullari i Ndërmarrjes me qëllim implementimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit gjatë vitit 2016 duhet të hartojë objektivat themelore të punës dhe përgatitjen e rregullores së funksionimit të Ndërmarrjes dhe ta miratojë këtë të fundit në Këshillin Bashkiak.

Brenda vitit 2016

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi mënyrën e organizimit, funksionimit dhe shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Bashkisë konstatohet se Këshilli Bashkisë Kurbin nuk ka hartuar rregulloren e veprimtarisë të Këshillit në kundërshtim me nenin 54 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke mos disiplinuar organizimin dhe funksionimit e këtij Këshilli si dhe të drejtat dhe detyrimet e këshilltarëve bashkiak.

10.1 Rekomandim: Për të disiplinuar organizimin dhe funksionimit e Këshilli Bashkiak Kurbin, si dhe për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e këshilltarëve të bashkisë, mbështetur në neni 54 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të hartohet dhe miratohet Rregullorja për organizimin e funksionimin e veprimtarisë të këshillit të bashkisë Kurbin”.

Brenda vitit 2016

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se nga koha e marrjes në punë të policëve bashkiak deri më sot të 9 punonjësit e policisë nuk kanë kryer as edhe një kualifikim dhe trajnim, sipas përcaktimeve të nenit 7 të ligjit nr. 8224, date 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkisë”, i ndryshuar.

11.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin, në zbatim të 7 të ligjit nr. 8224, date 15.05.1997, i azhurnuar Punonjësit e Policisë Bashkisë Kurbin ti nënshtrohen kualifikimit dhe trajnimit duke i kërkuar organeve të Policisë Shtetit që ky kualifikim të planifikohet e realizohet periodikisht për të gjithë punonjësit e policisë bashkiake.

Brenda vitit 2016

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet kryerja e prokurimeve publike me mangësi në drejtim të moszbatimit të UMF nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, e konkretisht: Mungonte kërkesa e argumentuar nga sektorët e interesuar për kryerjen e shpenzimit; Nuk ishin përcaktuar sipas rastit specifikimet teknike të shërbimit, apo mallit që do të blihej; Nuk evidentohet ngritja e grupit për testimin e tregut dhe as çmimet e marra për bazë në llogaritjen e fondit limit; si dhe Në mjaft raste në urdhër prokurimet nuk është argumentuar fondi limit.

12.1 Rekomandim: Në zbatimin e procedurës së prokurimit të përpilohet kërkesa nga sektori i interesuar duke argumentuar domosdoshmërinë, të ngrihet grupi për llogaritjen e fondit limit dhe të studiohet tregu, sipas përcaktimeve të gjurmëve standarde të zhvillimit të procedurës.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në dosjen e tenderit nuk ka procesverbal të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për hapjen e tenderit, po kështu nuk është mbajtur procesverbal për vlerësimin e ofertave dhe renditjen përfundimtare të tyre, veprim ky në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe nenin 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në zbatim të germës “i” dhe përgjegjës është Njësia e Prokurimit, pasi njëri nga anëtarët e saj, sipas aktit të më sipërm, është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

13.1 Rekomandim: Në zbatim të kërkesave të LPP, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe nën monitorimin e Njesisë së Prokurimit të evidentohet me procesverbal çdo fazë e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe ky dokumentacion të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet e kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Kurbin dhe Njësive Administrative Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe, është vepruar në kundërshtim

me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim. Në kundërshtim me nenin 31/d, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

14.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kurbin të merren masat dhe të kryhen të gjitha procedurat për mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik, etj.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet, pyjet e kullotat e kaluara me VKM në pronësi apo përdorim të Bashkisë Kurbin dhe Njësi Administrative Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe, nuk është kryer azhurnimi periodik i tyre, si dhe për pyjet e kullotat nuk është bërë procesverbali i dorëzimit nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Lezhë, duke bërë që gjendja dokumentare e tyre të mos përputhet me realitetin sipas terrenit, ku një pjesë e tyre nuk ekzistojnë, janë me sipërfaqe të ndryshme nga sa kaluar me VKM, apo kanë kaluar në pronësi të subjekteve me anë të lejeve të legalizimit të lëshuara nga ALUIZNI.

15.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kurbin, të merren masat dhe të kryhen të gjitha procedurat për azhurnimin e përditësimin e të gjitha aseteve në pronësi e përdorim, pyjeve e kullotave, për të gjithë territorin administrativ të saj. Në përfundim të këtij procesi të miratohet listinventari aktual i pasurive duke kërkuar miratimin nga Këshilli i Ministrave të listës përfundimtare të pronave të NJQV.

Brenda vitit 2016

16. Gjetje nga auditimi: Për Objekti në Pallatin e Kulturës “*Lokal Bar-Bufe dhe lokal bodrum me lulishte*” dhënë me qira prej vitit 2003, për të cilin KLSH në vitin 2011 dhe 2014 ka konstatuar se, personi qiramarrës nuk ka dorëzuar objektin të cilin ka vazhduar ta posedojë, gëzojë dhe disponojë, pa kryer pagesën e qirasë duke rekomanduar Bashkinë Laç për kërkimin e vlerës së qirasë dhe kamatëvonesave prej **9,109,476 lekë**. Deri më tani janë ndjekur një sërë procesesh gjyqësore por nuk është ndërmarrë as edhe një hap tjetër ligjor e procedural për kërkimin e vlerës së qirasë nga subjekti [REDAKTUAR] dhe lirimin e pronës, duke i mundësuar subjektit përdorimi i pronës në mënyrë të paligjshme dhe pa kundërshpërblim, duke mos gjetur zbatim VKM nr. 54, datë 05.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, duke sjellë për pasojë rritjen e vlerës të qirasë në shumën prej 6,673,140 lekë (qira dhe kamatëvonesa nga viti 2005 deri më 30.06.2011) dhe 4,377,744 lekë (2,721,600 lekë për 54 muaj nga data 01.07.2011 deri më 31.12.2015, si dhe kamatëvonesa për 1643 ditë, në shumën prej 1,656,144).

16.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kurbin në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Rendit, të merren masa për lirimin e menjëhershëm të Pallatit të Kulturës, si dhe të kryhen të gjitha procedurat ligjore për detyrimin e subjektit për të paguar detyrimin prej **13,487,220 lekë**, të krijuar nga viti 2005 e në vazhdim. Pas lirimit të objektit të shikohen të gjitha mundësitë për vënien e tij në eficensë të sipas qëllimit të krijimit apo nevojave të

bashkisë, apo dhe mundësinë e krijimit të të ardhurave nga dhënia në përdorim të përkohshëm të tij.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht VKM-të respektive për Bashkinë Kurbin dhe Njësitë Administrative Mamurras, Milot dhe Fushë-Kuqe, për kalimin në pronësi të aseteve, pyjeve e kullotave, të cilat kanë ngarkuar NJQV për regjistrimin e të gjitha pasurive në ZVRPP Kurbin, në zbatim të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Për të gjitha asetet në pronësi apo përdorim, është vepruar në kundërshti me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim. Për pronat të cilat rezultojnë të zëna forcërisht, nuk janë marrë masat e nevojshme për lirimin e tyre nga zaptuesit dhe përdoruesit e paligjshëm të tyre.

17.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin, Sektori i Menaxhimit të Pronave, të vijoj të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin në ZVRPP të pasurive të kaluara në pronësi, të mbaj dhe përditësoj regjistrin kontabël të aktiveve në pronësi apo administrim, si dhe për ato pasuri të cilat rezultojnë të zëna forcërisht të marrë masat për lirimin e tyre dhe vënin në funksion e përdorim të komunitetit, sipas destinacionit të përcaktuar në VKM apo në vendimet e Këshillit Bashkiak.

Brenda vitit 2016

18. Gjetje nga auditimi: Për objektin “Çerdhe fëmijësh në katin e dytë” për të cilin nga Bashkia Laç është lidhur kontrata e qirasë datë 25.05.2009, për çerdhe me sipërfaqe 67 m², dhe objektin “Tregu i fruta perimeve” për të cilin nga Bashkia është lidhur kontrata e qirasë nr.1659 datë 13.10.2008, për vlerën prej 30 lekë/m² ose 30 lekë për çdo tavolinë shitjeje por jo më pak se 30.000 lekë në mua, janë paguar rregullisht detyrimet mujore sipas kontratave, por nga Bashkia Kurbin nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 54, datë 05.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, pasi kontrata nuk ka të bashkëlidhur asnjë dokument, si psh. Certifikatën e pronësisë, ku prona të jetë regjistruar në ZVRPP, Kopje të Hartës Treguese të Regjistrimit, për identifikimin e objektit dhe sipërfaqes së tij, genplan të hartuar nga bashkia për objektin dhe të konfirmuar nga kryetari i saj, vendim të Këshillit Bashkiak për dhënien me qira të objektit, miratim të genplanit nga Prefekti i Qarkut Lezhë, etj.

18.1 Rekomandim: Nga Bashkia Kurbin, të merren të gjitha masat dhe të plotësohen dosjet me dokumentacionin e nevojshëm teknik e ligjor, sipas kërkesave të VKM nr. 54, datë 05.2.2014, ndryshuar me VKM nr. 299, datë 20.04.2016.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha praktikat e audituara konstatohet se nuk ka Vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, ku të jetë bërë konfirmimin e situacionit përfundimtar të punimeve, pra të pasqyrojë vlerën përfundimtare të objektit, por vetëm vërtetim se subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara etj.

19.1 Rekomandim: Drejtoria e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit, për objektet “Shtesë anësore dhe ngritje 6kt+podrum” dhe “Godinë polifunksionale 2kt tregtare + 6 kate banim + 1kt parkim”, ti kërkoj subjekteve situacionin përfundimtar të konfirmuar apo ti drejtohet zyrtarisht Drejtorisë Rajonale Tatimore, që për objektet për të cilat është lëshuar certifikatë

përdorimi të konfirmojnë zyrtarisht vlerën përfundimtare të punimeve, sipas faturave tatimore, pasqyrave financiare dhe situacionit përfundimtar të punimeve. DKPT në rast të konstatimit të vlerave tepër, të përlogarisë diferencat për tu paguar nga secili subjekt.

Menjëherë dhe për çdo rast

20. Gjetje nga auditimi: Nga Njësia Administrative Mamurras në 12 raste është aplikuar VKM nr. 608, datë 05.09.2012, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie si dhe për regjistrimin e tyre”, por subjektet kanë përfituar më tepër sa përcaktuar nga Dekreti nr. 5747, datë 22.7.1978, dhe nr. 7011/1985, i cili ka përcaktuar sipërfaqen deri në 200 m². Nga NJQV duhej vepruar duke përcjellë dosjet në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, sipas përcaktimit të VKM nr. 578, datë 29.8.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, pikës 9/i, “Të drejtën e tjetërsimit me shpërblim dhe detyrimin për të paguar brenda 30 ditëve, për llogari të AKKP-së, për fondin e kompensimit financiar, çmimin e tjetërsimit...”, mosveprime të cilat i kanë sjellë buxhetit të shtetit, fondit të kompensimit financiar të ardhura të munguar në vlerën prej **8,574,399 lekë** (sipas VKM nr. 514, datë 30.07.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark”, e cila ka përcaktuar se vlera për Bashkia Mamurras është 1557 lekë, pra 1557 lekë/m² x 5507 m²).

20.1 Rekomandim: Drejtoria e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit, për 12 rastet e aplikimit nga Njësia Administrative Mamurras të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, duke u përfituar nga subjektet më tepër se sa caktuar nga Dekreti nr. 5747, datë 22.7.1978, ndryshuar me Dekretin nr. 7011/1985, i cili ka përcaktuar sipërfaqen deri në 200 m² në fshatrat fushor, të kërkoj nga ZVRPP që në referim të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të bëj vendosjen e masave kufizuese mbi secilën pasuri, si dhe ti drejtohet ATP, për marrjen në shqyrtim të secilës praktikë për tjetërsimin e pronës me kundërshtëpërblim.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga Njësia Administrative Mamurras për 7 objekte me leje ndërtimi, dhe Njësia Administrative Milot për 19 objekte me leje ndërtimi, nuk ka gjetur zbatim ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 40 dhe 52, “shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve” dhe “përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit”, duke bërë që Bashkisë Kurbin ti jenë krijuar të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej **13,000,000 lekë** (26 leje x 500,000 lekë), sipas aneksit.

21.1 Rekomandim: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **13,000,000 lekë**, duke u kryer nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, inspektimi në terren i secilit objekt dhe mbajtja e akteve përkatëse, ku të evidentohet se jemi para faktit të shkeljes së afatit të lejes apo përdorimit të objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Për objektin: “Shtesë anësore dhe ngritje 6kt + podrum”, në lagjen nr. 2 Laç”, është konstatuar se me vendimin nr. 2, datë 27.11.2013 “Për dënimin me gjobë”, Investitori ka shkelur sipërfaqen e lejes së ndërtimit me 443,6 m² dhe sasinë e kateve nga 3 kate+lokal në 6 kate. Lidhur me masën e gjobës rezulton se nuk ka gjetur zbatim plotësisht e saktësisht nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 82 “Kundërvajtjet administrative”, pasi është aplikuar pika 7 “Shkelja e kushteve të leje”, kur duhej aplikuar pika 8 “Kryerja e punimeve pa leje”, shkronja “b” me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dënohen me gjobë nga **200,000 lekë**, shumë e cila përbën të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e NJQV, Bashkia Kurbin.

kundërshtim me preventivin e paraqitur ne tender dhe kontratën e zbatimeve të punimeve lidhur me sipërmarrësin nr. 364/15, datë 26.08.2013.

3.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **2,147,844 lekë** pa tvsh nga OE “XXXXXXXXXX” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 364/15, datë 26.08.2013 me objekt “*Rikonstruksioni Shkollës nr. 2, Mamurras*”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim Kopsht Fëmijësh Milot*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca (mos kryerje punimesh) në vlerën **1,140,719 lekë** pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, në kundërshtim me preventivin e paraqitur ne tender dhe kontratën e zbatimeve të punimeve lidhur me sipërmarrësin nr. 04/6, datë 24.12.2012.

4.1.Rekomandim: Bashkia Kurbin të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,420,131 lekë pa tvsh** nga OE “XXXXXXXXXX” sha, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 04/6, datë 24.12.2012 me objekt “*Ndërtim Kopsht Fëmijësh Milot*”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga procesverbalet e mbledhjeve të zhvilluara në vitet 2014 e 2015 nga ish-Këshillat Bashkiak e Komunal të Bashkisë Laç e Mamurras dhe Komunave Fushë-Kuqe e Milot, listëprezencave dhe borderove të shpërblimit të këshilltareve, është konstatuar se janë shpërblyer këshilltarët kur nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet mujore të këshillave bashkiake dhe komunare, si dhe plotësimi i listëprezencave është paraqitur me mungesa të këshilltareve, pagesa në kundërshtim me nenin 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore*”. Shuma e përfituar padrejtësisht nga këshilltarët e bashkisë Laç e Mamurras dhe komunave Milot e Fushë-Kuqe, është në vlerën totale 5,240,896 lekë.

5.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën totale **5,240,896 lekë**, nga ish-Këshilltarët e Këshillave të ish-Bashkisë Laç e Mamurras dhe ish-Komunat Milot e Fushë-Kuqe dhe konkretisht: ish-anëtarët e Këshillit Bashkiak Laç në vlerën 1,187,162 lekë, ish-anëtarët e Këshillit Bashkiak Mamurras në vlerë 2,025,875 lekë, ish-anëtarët e Këshillit Komunes Milot në vlerën 1,333,800 dhe të ish-anëtarët e Këshillit Komunes Fushë-Kuqe në vlerën 694,059 lekë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga 11 personat janë përfituar padrejtësisht duke llogaritur gabim vjetërsinë në punë në vlerën 65,440 lekë, në kundërshtim me UKM nr.1, datë 13.06.2001, i ndryshuar me nr.4, datë 07.02.2010 “*Për strukturën e renditjes së punëve në shërbimin civil, metodologjisë përkatëse dhe përshkrimit përgjithësues të rolit të Sekretarit Përgjithshëm në këtë shërbim*”.

6.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën **65,440 lekë**, detyrim i përfituar padrejtësisht nga punonjësit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Referuar përgjigjeve të sjella nga DRSSH, me shkresën nr. 2202/1, datë 26.05.2015, ka rezultuar se z. [REDAKTUAR] përfiton pension invalidi në masën 15,140 lekë/muaj. Nga verifikimi i listë pagesave për vitin 2015 ka rezultuar se z. [REDAKTUAR] me numër dosje 1765 dhe familja e tij nuk kanë përfituar NE për muajin Qershor, por kanë hyrë përsëri në skemën e NE dhe kanë vazhduar të paguhen në muajt Korrik Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor. Nisur sa lart z. P N K pasi përfiton nga pensioni i invaliditetit në shumën 15,140 lekë/muaj, bazuar në pikën 18/3 të VKM nr. 96 nuk i llogaritet masë NE në strukturën e masës së NE dhe si rrjedhojë pagesa si kryefamiljar në shumën 13,000 lekë është përfituar padrejtësisht.

7.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 13,000 lekë*, për P K, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Referuar shkresës nr. 253, datë 01.06.2015, të DRSSH, personat z. [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR] marrin pension invaliditeti. Nga verifikimi i listë pagesave për vitin 2015 rezultoi se shtetasit nuk kanë përfituar NE për muajin Korrik, por kanë hyrë përsëri në skemën e NE dhe kanë vazhduar të paguhen padrejtësisht në total 23,000 lekë, në muajt në vazhdim e konkretisht në muajt Gusht-Dhjetor me ndihmë të plotë nga 4,600 lekë për çdo muaj.

8.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 23,000 lekë*, për [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Referuar shkresës nr. 3030/1, datë 03.08.2015, të DRSSH, ka rezultuar se znj. [REDAKTUAR] përfiton pension invaliditeti deri më 31.08.2018 me masë 8,186 lekë/muaj. Nga verifikimi i listë pagesave për vitin 2015 rezultoi se shtetasja edhe pse përfiton pension invaliditeti ka përfituar padrejtësisht në total 13.000 lekë edhe NE e konkretisht në muajt Gusht-Dhjetor 2015.

9.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 13,000 lekë*, për [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 1643, datë 24.04.2015, DRSSH, i ka kthyer përgjigje Bashkisë Kurbini se personi z. [REDAKTUAR], përfiton pension invaliditeti në shumën **82,514 lekë** ndërkohë që bazuar në listë pagesat ka rezultuar se ka dalë nga skema e NE në muajin Maj, ndërkohë është rifutur përsëri në skemë duke përfituar, në emër të bashkëshortes e konkretisht: Për Qershorin ka përfituar kompensim energjie elektrike në shumën 1,288 lekë dhe NE 5,900 lekë, për Korrik-Shtator z. [REDAKTUAR] dhe bashkëshortja kanë përfituar 5,600 lekë për çdo muaj duke ju hequr kompensimin për energji elektrike, për Tetorin dhe Nëntorin ka përfituar 5,600 lekë në muaj plus 1,288 lekë kompensimin e energjisë dhe për Dhjetorin ka përfituar 6,888 lekë. Në total kjo familje ka përfituar padrejtësisht pagesën prej **18,200 lekë** të Kryetarit të familjes i cili është trajtuar me pension invaliditeti.

10.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 18,200 lekë*, [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Referuar shkresës nr. 3995/1, datë 27.10.2015, të DRSSH ka rezultuar se z. [REDAKTUAR] përfiton pension invaliditeti deri në 2016 në shumën 19.104 lekë. Nga verifikimi i listë pagesave për vitin 2015, ka rezultuar se shtetasi ka përfituar NE për muajt Nëntor-Dhjetor gjithsej 190,576 lekë. Për sa lart z. [REDAKTUAR] nuk i llogaritet masë NE në strukturën e masës së NE dhe si rrjedhojë pagesa prej 2,600 lekë/muaj si kryefamiljar në skemën e NE dhe shuma gjithsej 5,200 lekë për muajt e sipërcituar është përfituar padrejtësisht.

11.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 5,200 lekë*, për [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Referuar shkresës nr. 3995/1, datë 27.10.2015, të DRSSH ka rezultuar se z. [REDAKTUAR], përfiton pension invaliditeti deri në 2016 në shumën 15.952 lekë. Nga verifikimi i listë pagesave për vitin 2015 shtetasi ka përfituar NE për muajt Nëntor dhe Dhjetor gjithsej 6,576 lekë e konkretisht duke përfituar 1,288 lekë kompensim energjie elektrike dhe 2,000 lekë NE për çdo muaj.

12.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 6,576 lekë*, për [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Referuar shkresës nr. 491, datë 19.11.2015, të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ka rezultuar se z. [REDAKTUAR] ka filluar punë si i vetëpunësuar për muajin nëntor 2015. Nga verifikimi i listë pagesave rezultoi se shtetasi është paguar në muajin dhjetor 2015 me NE të plotë në shumën 3,900 lekë.

13.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 3,900 lekë*, për [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Për periudhën Gusht-Dhjetor 2015, në të 6-të Vendimet e Këshillit Bashkiak, ishin përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike 66 familje për shkak të mos plotësimit të deklaratës mujore, Bashkia Kurbin për 13 përfitues të tjerë të NE, ka përdorur një tjetër standard, pasi edhe pse këta individë nuk kanë paraqitur deklaratën mujore ata kanë vazhduar të qëndrojnë në skemë dhe nga verifikimi i listë pagesave për vitet 2014-2015 ata janë paguar në total në shumën **258,668 lekë**, sipas përcaktimeve të bëra në listën bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

14.1 Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen *ndalesat në vlerën 258,668 lekë*, nga të gjithë përfituesit e Ndihmës Ekonomike, të cilët nuk kanë plotësuar deklaratat e paraqitjes mujore, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt: “*Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave 1+2+3, Laç*”, periudha e janarit 2014 është mbuluar me shtesë kontrate nr. 1326/2, datë 05.11.2013, sipas të cilës shoqërisë [REDAKTUAR] i është miratuar shtesë kontrate në vlerën prej 4,108,200 lekë pa tvsh ose 4,929,840 lekë me tvsh.

Nga Bashkia është paguar më tepër se kontrata pasi aktualisht është paguar në vlerën prej 4,877,810 lekë pa tvsh, me një diferencë tepër në shumën prej **769,610 lekë** pa tvsh shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore.

Për pagesat e kontratës aktuale të vitit 2014, kontrata i ka filluar efektet e saj për periudhën 04.4.2014 dhe për vitin e parë kalendarik duhet të llogaritej 8 muaj shërbim $22,912,631/12=1,909,386$ (për muaj) x 9 muaj = 17,184,474 leke pa tvsh kur në fakt është 17,512,860 lekë, pra paguar më tepër **328,386 lekë** pa tvsh, shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e NJQV Bashkia Kurbin.

15.1 Rekomandim: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **1,097,996 lekë**, përfituar padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR] shpk, si pasojë e pagesës së shërbimeve tej vlerës së përcaktuar në kontratë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Për objektin e dhënë me qira nga Njësia Administrative Milot, kontrata datë 10.03.2014 *personit juridik* “[REDAKTUAR]” shpk, dhe objekt: “*Dhënia me qira për përdorim të sipërfaqes prej 0.45 km, tokë pyjore që do të shërbejë për ndërtimin e rrugës, për të shkuar tek hidrocentrali në fshatin Vinjollë; sipërfaqe prej 2.95 km, që do të shërbejë për shtrirjen e tubacioneve dhe për hapjen e kanalit të ujit; si dhe sipërfaqen prej 2.75 km, ku do të ndërtohet linja elektrike e tensionit të lartë, për tu lidhur me rrjetin elektrik kombëtar*”, nuk është kërkuar kryerja e pagesës për vitin 2015, në vlerën prej **699,375 lekë**, si dhe shuma prej **69,940 lekë**, si kamatë vonesë në pagesë (10% e vlerës totale të pagesës).

Nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar pasi sipas vendimit nr. 4, datë 21.12.2010, të miratuar nga Ish-KRRT Komuna Milot është dhënë leje ndërtimi për “[REDAKTUAR]” shpk, ku sipas lejes dhe planimetrisë është miratuar dhe ndërtimi i objektit “Godina e Stacionit” e cila rezulton me sipërfaqe prej 145 m². Nënshkrimi i kontratës me qëllim përdorimin e sipërfaqes për vendosje stacioni hidrocentrali etj. dhe nxjerrja dhe miratimi i lejes zhvillimore, ka bërë që sipërfaqja e marrë me qira të kthehet në truall në zhvillim, në kuptim të ligjit aktual nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, pra të mos jetë më pjesë e fondit pyjor e kullësor, por tokë truall, për aq kohë sa kjo marrëveshja/kontratë është në fuqi Mosaplikimi i VKM-së nr. 54, për sipërfaqen prej 145 m² ka sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej **304,500 lekë** (145m² x 100 lekë/m² x 21 muaj (mars 2014-dhjetor 2015)).

16.1 Rekomandim: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **1,073,815 lekë**, si pagesa të pakryera dhe kamatëvonesa të pa llogaritura për shoqërinë “[REDAKTUAR]” shpk, si dhe moslidhjen e kontratës së qirasë së truallit prej 145m², duke kërkuar njëkohësisht përcaktimin në shtesë kontrate apo përditësimin në kontratën bazë të vlerës së qirasë së tokës truall.

Menjëherë

B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rehabilitimi i rrugëve e lulishteve midis pallateve lagjja “Zef Hoti, Mamurras*”, nga auditimi u konstatua se operatori ekonomik Shoqëria [REDAKTUAR] sh.p.k., është skualifikuar, edhe pse i ka plotësuar kërkesat për kualifikim.

Operatori ekonomik duhej të ishte kualifikuar dhe të ishte shpallur fituese. Diferenca në shumën 2,000,270 lekë pa tvsh, ndërmjet ofertës së Shoqërisë [REDAKTUAR] në shumën 6,383,960 lekë pa tvsh me ofertën e Shoqërisë [REDAKTUAR], të shpallur fituese në shumën 8,383,230 lekë pa tvsh, përbën mospërdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, veprime në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes, Kreu I “Dispozita të përgjithshme”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, germa (ç), pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike, për procedurën e prokurimit me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **2,000,270 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Brenda vitit 2016

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 58 shkronja “b” e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, datë 30.05.2013 i ndryshuar, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në mbështetje të neneve 15 dhe 25 të ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Kurbin që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, nga masa disiplinore - **Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, e parashikuar në nenin 58, germa “b” deri në masën “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit**”, për 16 punonjës si më poshtë:

1. znj. M.C. me detyrë Specialiste e Ndhmës Ekonomike, për:

- Dhënien e NE invalidëve të punës të cilët bazuar në pikën 18/3 të VKM nr. 96, datë 07.02.2012, nuk i llogaritet masë NE”;
- Procesin e verifikimit për vlerësimin social ekonomik të gjendjes së familjes apo të anëtarëve të saj, proces i cili ka qenë jo i plotë;
- Kërkesat për ndihmë ekonomike të cilat nuk nënshkruheshin nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes;
- Mosplotësimin e dosjeve me vërtetimet si punëkërkuar të papunë për të gjithë anëtarët e familjes të aftë për punë;
- Mos përjashtimin nga skema e ndihmës ekonomike të familjeve për shkak të mos plotësimit të deklaratës mujore.

2. znj. E.J. me detyrë Drejtore e Financës dhe N/Z në Bashkinë Kurbin, për:

- Mos respektimin e procedurave për paraqitjen e kërkesave buxhetore dhe kërkesave shtesë sipas programit tek nëpunësi autorizues i NjQV-së, brenda datës 15 Maj 2014.
- Mosparaqitjen e PBA-së 2015-2017, në Ministrinë e Financave brenda Qershorit

-Miratimin e projekt-buxheteve për vitet 2014-2015, jashtë afatit ligjor, në kundërshtim me nenin 32, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

-Mosrespektimin e kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

-11 raste të llogaritjes të gabuar të shtesës së pagës për vjetërsinë në punë të punonjësve të Bashkisë Laç, sot Kurbin, për vitet 2014-2015, duke shkaktuar buxhetit të njësisë të qeverisjes vendore, dëmin ekonomik në vlerën prej 65,440 lekë.

-Procedurat e zbatimit të prokurimit “Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave”, pasi për pagesat e kontratës aktuale të vitit 2014 nuk është marrë parasysh që kontrata i ka filluar efektet e saj për periudhën 04.4.2014 dhe për vitin e parë kalendarik duhet të llogaritej 8 muaj shërbim $22,912,631/12=1,909,386$ (për muaj) x 9 muaj = 17,184,474 lekë pa TVSH kur në fakt është 17,512,860 lekë, pra paguar më tepër 328,386 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Kurbin.

-Procedurat e zbatimit të prokurimit “Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave”, pasi periudha e janarit është mbuluar me shtesë kontrate nr. 1326/2, datë 05.11.2013, ku sipas kontratës shërbimi është përcaktuar në vlerën prej 4,108,200 lekë pa tvsh ose 4,929,840 lekë me tvsh dhe aktualisht është paguar në vlerën prej 4,877,810 lekë pa tvsh ose 5,853,372 lekë me tvsh, me një diferencë tepër në shumën prej 923,532 lekë me tvsh dhe 769,610 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Kurbin.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt “**Ndriçimin e brendshëm të shesheve të lagjeve të qytetit të Laçit**”, në vlerën prej 1,248,648 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht Operatori ekonomik në regjistrin e ekstraktit historik të lëshuar nga QKR, në objektin e aktivitetit nuk ka të miratuar kryerje të punimeve në rrjetin elektrik; Puna e ngjashme e paraqitur është për instalime linja elektrike në shtëpi private dhe jo në sistem ndriçimi të një qyteti; Formulari i vlerësimit nuk është sipas formatit të shtojcës 8 të DST; Certifikatat e cilësisë së punimeve (ISO), janë në gjuhë të huaj dhe të pa përkthyer në gjuhën shqip, siç kërkohet në DST.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2015, me objekt “**Blerje materiale ndërtimi për sistemin e disa prej rrugëve të Lagjes nr. 5 (Sanxhak) Laç**”, në vlerën prej 2,280,000 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht Bilaci kontabël i vitit 2014 është i pa certifikuar nga organet kompetente Drejtoria Rajonale e tatimeve Lezhë; Kapaciteti teknik për furnizime të ngjashme operatori ekonomik ka paraqitur faturat tatimore për blerje betoni dhe hekuri në vitin 2013 dhe jo kontrata furnizimi me materialet e ndërtimit që prokurohen; Certifikatat e cilësisë ISO janë paraqitur në gjuhë të huaj dhe jo në gjuhën shqipe siç kërkohet në dokumentet e tenderit.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në

kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt “**Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra të qytetit të Laçit**”, në vlerën prej 37,711,115 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht për vitin 2013 dhe muajin janar të vitit 2014 nuk ka plotësuar kërkesën për të pasur mesatarisht 12 punonjës të siguruar.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. znj. I.M., me detyrë specialiste të ndihmës ekonomike,

4. znj. I.Gj. me detyrë specialiste të ndihmës ekonomike,

5. znj. A.L. me detyrë specialiste të ndihmës ekonomike, për:

-Dhënien e NE invalidëve të punës të cilët bazuar në pikën 18/3 të VKM nr. 96, datë 07.02.2012, nuk i llogaritet masë NE”;

-Procesin e verifikimit për vlerësimin social ekonomik të gjendjes së familjes apo të anëtarëve të saj, proces i cili ka qenë jo i plotë;

-Kërkesat për ndihmë ekonomike të cilat nuk nënshkruheshin nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes;

-Mosplotësimin e dosjeve me vërtetimet si punëkërkues të papunë për të gjithë anëtarët e familjes të aftë për punë;

-Mos përjashtimin nga skema e ndihmës ekonomike të familjeve për shkak të mos plotësimit të deklaratës mujore.

6. z. P.K. me detyrë Drejtore e Financës dhe N/Z në Bashkinë Kurbin, për:

-Për 11 raste të llogaritjes të gabuar të shtesës së pagës për vjetërsinë në punë të punonjësve të Bashkisë Laç, sot Kurbin, për vitet 2014-2015, duke shkaktuar buxhetit të njësisë të qeverisjes vendore, dëmin ekonomik në vlerën prej 65,440 lekë.

7. z. A.Gj. me detyrë Specialist i Drejtorisë së Kontrollit dhe Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e supervisorit të “Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave”, për:

-Procedurat e zbatimit të prokurimit “*Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave*”, pasi për pagesat e kontratës aktuale të vitit 2014 nuk është marrë parasysh që kontrata i ka filluar efektet e saj për periudhën 04.4.2014 dhe për vitin e parë kalendarik duhet të llogaritej 8 muaj shërbim $22,912,631/12=1,909,386$ (për muaj) x 9 muaj = 17,184,474 lekë pa TVSH kur në fakt është 17,512,860 lekë, pra paguar më tepër 328,386 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Kurbin.

-Procedurat e zbatimit të prokurimit “*Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave*”, pasi periudha e janarit është mbuluar me shtesë kontrate nr. 1326/2, datë 05.11.2013, ku sipas kontratës shërbimi është përcaktuar në vlerën prej 4,108,200 lekë pa tvsh ose 4,929,840 lekë me tvsh dhe aktualisht është paguar në vlerën prej 4,877,810 lekë pa tvsh ose 5,853,372 lekë me tvsh, me një diferencë tepër në shumën prej 923,532 lekë me tvsh dhe

769,610 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Kurbin.

8. z. A.LI. me detyrë Specialiste e Shpenzimeve në Drejtorinë e Financës, për:

-Procedurat e zbatimit të prokurimit “Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave”, pasi për pagesat e kontratës aktuale të vitit 2014 nuk është marrë parasysh që kontrata i ka filluar efektet e saj për periudhën 04.4.2014 dhe për vitin e parë kalendarik duhet të llogaritej 8 muaj shërbim $22,912,631/12=1,909,386$ (për muaj) x 9 muaj = 17,184,474 lekë pa TVSH kur në fakt është 17,512,860 lekë, pra paguar më tepër 328,386 lekë, shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Kurbin.

-Procedurat e zbatimit të prokurimit “Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të varrezave”, pasi periudha e janarit është mbuluar me shtesë kontrate nr. 1326/2, datë 05.11.2013, ku sipas kontratës shërbimi është përcaktuar në vlerën prej 4,108,200 lekë pa tvsh ose 4,929,840 lekë me tvsh dhe aktualisht është paguar në vlerën prej 4,877,810 lekë pa tvsh ose 5,853,372 lekë me tvsh, me një diferencë tepër në shumën prej 923,532 lekë me tvsh dhe 769,610 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Kurbin.

-Objektin “Çerdhe fëmijësh në katin e dytë” lidhur kontrata e qirasë nr. 858, datë 06.06.2014 dhe 2542, datë 07.12.2015, në shumën totale prej 241,200 lekë (24 muaj x 67 m²x150 lekë/m²). Pavarësisht pagesës rezulton se nga Bashkia Kurbin nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016, pasi kontrata nuk ka të bashkëlidhur asnjë dokument, si psh. Certifikatën e pronësisë, ku prona të jetë regjistruar në ZVRPP, Kopje të HTR, për identifikimin e objektit dhe sipërfaqes së tij, genplan të hartuar nga bashkia për objektin dhe të konfirmuar nga kryetari i saj, vendim të Këshillit Bashkiak për dhënien me qira të objektit, miratim të genplanit nga Prefekti etj, sipas përcaktimeve të Kreu II “Procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”.

-Objektin “Tregu i fruta perimeve”, ku është lejuar subjekti të përdorin sendin edhe pse kontrata e qirasë ka përfunduar prej vitit 2009; ku pagesa e shpenzimeve për energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm përballohet nga qiradhënësi dhe për rrjedhojë për gjithë periudhën e mësipërme, në kundërshtim me dispozitat ligjore për qiradhënien **pagesa e energjisë elektrike dhe e ujit të shpenzuar** nga tregu privat në qytetin e Laçit është likuiduar nga vetë institucioni pasi nga qiramarrësi nuk janë vendosur matësit e energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm dhe nuk janë lidhur kontratat me CEZ/OST dhe Ujësjellësin, veprime e mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016.

-Në tenderin me objekt “**Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra të qytetit të Laçit**”, nuk është argumentuar si është llogaritur norma ditore e punës për punimet që do të kryen dhe si është llogaritur sasia e materialeve që do të përdoren dhe cilat çmime janë marrë për bazë në llogaritjen e vlerës së materialeve, duke sjell për rrjedhojë fond limit të paargumentuar.

-Në praktikat e **prokurimit të nevojave për karburant** të zhvilluara në vitin 2014 dhe vitin 2015, në kërkesat për kualifikim nga Njësia e Prokurimit nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin dokumentacion për punonjësit e siguruar, bilancet e pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme, shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë e qeverisjes vendore ku zhvillojnë veprimtarinë, etj; Mungon kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit; Mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit, specifikimeve teknike dhe fondit limit; Mungon miratimi i treguesve teknikë nga titullari i Bashkisë; Kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga Njësia e Prokurimit dhe jo nga specialisti i ngarkuar; Nuk është përcaktuar sasia e karburantit mbi bazën e mjeteve në dispozicion të Bashkisë dhe volumin e punës që parashikohet të realizohet; Nuk është evidentuar çmimi i karburantit i përdorur dhe marzhi i fitimit i marrë për bazë në llogaritjen e fondit limit.

-Për llogaritjen e çmimit të karburantit Njësia e Prokurimit është mjaftuar me të dhëna e buxhetit për karburant dhe nuk ka marrë për bazë të dhënat e botuara në buletin e APP të periudhës përkatëse për çmimet e karburantit të bursës sipas Reuters të datës kur u hartuan dokumentet e tenderit për kryerjen e prokurimit, si dhe nuk është bërë asnjë llogaritje se sa do të merret çmimi i karburantit për të llogaritur fondin limit. Pra për përcaktimin e çmimit të karburantit në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit.

-Në dokumentet e tenderit, në përcaktimin e specifikimeve teknike nuk janë përcaktuar karakteristikat e mallit, treguesit kimikë e fizikë të tij dhe kërkesa e vërtetimit të tyre me analiza nga laboratorë të njohur për këtë qëllim, por thuhet “në përputhje me standardet në fuqi S SHEN 590:2013” pa i specifikuar, duke mos argumentuar fondin limit.

-Kanë hartuar dokumentet e tenderit me preventiv e specifikime teknike të pa miratuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe për mungesën e projektit e specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit në formatin elektronik, ku si rrjedhojë, është vepruar në kundërshtim me nenin 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët e standardeve të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

9. z. A.B. me detyrë Drejtor i Planifikimit të Ardhurave Vendore, për:

-Mos administrimin e mirë të taksave e tarifave vendore, me pasoja ulje të ndjeshme në të ardhurat dhe fondet vendore, duke sjellë ulje të mundësive për investime dhe shërbime publike për komunitetin, në zbatim të neneve, 101, 111/1, 117 dhe 118, të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe në zbatim të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, i ndryshuar, “Për sistemin e taksave vendore”,

-Ushtrimin e aktivitetit duke punuar pa përgjegjësi në vjeljen e taksave, si taksa e biznesit vogël, taksa e tokës bujqësore, tarifa e pastrimit dhe ndikimi në infrastrukturë, që nga vetë përbërja zënë peshën me të madhe në të ardhurat, karakteristike kjo për të dy vitet objekt kontrolli.

-Mos arkëtimin për vitin 2014 të 40 subjekteve debitorë të taksave e tarifave vendore në vlerën prej 649,749 lekë dhe për vitin 2015 të 36 subjekteve debitorë të taksave e tarifave vendore në vlerën prej 573,167 lekë.

Mos realizim të taksës së ndërtesës e cila për vitin 2014 rezulton e pa realizuar në masën 65 %

-Taksën e fjetjes ne hotel, edhe pse në Bashkinë Kurbin, rezulton të kryej aktivitet hotelerie, një subjekt, nuk rezulton të jetë kryer një procedurë lidhur me:

-Njoftimin për shumat e përlllogaritura të derdhjes së detyrimit, për subjektin i cili ushtron këtë aktivitet.

- Verifikimin nga inspektorët tatimor, të ushtrimit të aktivitetit, regjistrimit të subjektit në QKR për ushtrimin e aktivitetit.

- Mbajtjen e dokumentacionit të regjistrimit të klientëve dhe llogaritjen e taksës së hotelit, mbi bazën e përqindjes së miratuar të çmimit të fjetjes.

-Taksa është planifikuar për 50 mijë lekë në vit, por realisht është arkëtuar një shumë prej 5 mijë lekësh për vitin 2015; hotel i cili sipas të dhënave nuk funksionon rregullisht, nuk është i regjistruar në QKR, nuk ka një proces-verbal konstatimi në ditë të ndryshme të muajt, që vërteton se a zhvillon aktivitet apo jo ky subjekt.

-Objektin “Çerdhe fëmijësh në katin e dytë” lidhur kontrata e qirasë nr. 858, datë 06.06.2014 dhe 2542, datë 07.12.2015, në shumën totale prej 241,200 lekë (24 muaj x 67 m²x150 lekë/m²). Pavarësisht pagesës rezulton se nga Bashkia Kurbin nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016, pasi kontrata nuk ka të bashkëlidhur asnjë dokument, si psh. Certifikatën e pronësisë, ku prona të jetë regjistruar në ZVRPP, Kopje të Hartës Treguese të Regjistrimit, për identifikimin e objektit dhe sipërfaqes së tij, genplan të hartuar nga bashkia për objektin dhe të konfirmuar nga kryetari i saj, vendim të Këshillit Bashkiak për dhënien me qira të objektit, miratim të genplanit nga Prefekti i Qarkut Lezhë, etj, sipas përcaktimeve të Kreu II “Procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”.

-Objektin “Tregu i fruta perimeve”, ku është lejuar subjekti të përdorin sendin edhe pse kontrata e qirasë ka përfunduar prej vitit 2009; ku pagesa e shpenzimeve për energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm përballohet nga qiradhënësi dhe për rrjedhojë për gjithë periudhën e mësipërme, në kundërshtim me dispozitat ligjore për qiradhënien **pagesa e energjisë elektrike dhe e ujit të shpenzuar** nga tregu privat në qytetin e Laçit është likuiduar nga vetë institucioni pasi nga qiramarrësi nuk janë vendosur matësit e energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm dhe nuk janë lidhur kontratat me CEZ/OST dhe Ujësjellësin, veprime e mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016.

10. z. E.S. me detyrë Drejtor i Kontrollit dhe Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, për:

-Mos kryerjen e detyrës të evidentimit dhe marrjes së informacionit për zhvillimet në territorin nën administrim nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera të planifikimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, Seksioni VII “Vëzhgimi, Inspektimi, Kundravajtjet e Dënimet”, neni 80 “Vëzhgimi i Zhvillimeve në Terren”, pika 1 dhe 2, neni 82/9, neni 40 “Afati i lejes së ndërtimit” dhe neni 52 “Kundravajtjet administrative”, pika “dh”, “shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve, duke bërë që Bashkisë Kurbin ti jenë krijuar të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 3,500,000 lekë, nga 7 ndërtime të pajisura me leje nga ish-Bashkia

Mamurras dhe 19 ndërtime në vlerën 9,500,000 lekë, të pajisura me leje nga ish-Komuna Milot.

-Objektin “Magazinë bimësh mjekësore për eksport 2 dhe 3 kat, në lagjen nr. 5, Laç”, ku është konstatuar se: Prona nuk ka Kopje Kartele të rifreskuar pasi KPP aktuale daton më 11.11.2013 dhe mban shënimin në seksionin E “Seksioni i Hipotekave, Vendimeve të Gjykatave, Kufizimeve etj” prona figuron me shënim datë 23.07.2013 “...lënë garant banka Kredins”, si dhe nuk ka deklaratë noteriale nga personi/subjekti në favor të të cilit është vendosur barra hipotekare, ku të deklarojë pëlqimin e tij për zhvillimin e mëtejshëm të sendit.

-Objektin “Rikonstruksion objekt shërbimi 1kt, në Fushë Mamurras”, ku është konstatuar se: Prona figuron me shënim datë 24.04.2014 “...lënë garant te Banka [REDAKTUAR]” dhe nuk ka deklaratë noteriale nga personi/subjekti në favor të të cilit është vendosur barra hipotekare, ku të deklarojë pëlqimin e tij për zhvillimin e mëtejshëm të sendit.

-Objektin “Objekt shërbimi 3 kate”, ku është konstatuar se: Vërtetimi nr. 276, datë 07.02.2014, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, nuk ka bërë konfirmimin e situacionit përfundimtar të punimeve, pra të pasqyrojë vlerën përfundimtare të objektit “Ndërtesë 3 kate shërbimi”, pasi është kufizuar vetëm në bërjen me dije se subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara etj.

Vërtetimi i pronësisë është ai i paraqitur në marrjen e lejes ndërtimore, pra nuk ka një KPP apo vërtetim pronësor të gjendjes aktuale të pasurisë si dhe nëse mbi këtë pronë janë vendosur shënime për masa të cilat kufizojnë të drejtën e pronarit mbi pasurinë, apo nëse ka pasur transaksione të cilat të kenë ndryshuar pronësinë.

-Objektin “Godinë Shërbimi dhe banimi 6kt+1 kt nën tokë”, ku është konstatuar se: Nuk ka Vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, ku të jetë bërë konfirmimin e situacionit përfundimtar të punimeve, pra të pasqyrojë vlerën përfundimtare të objektit, pasi është kufizuar vetëm në bërjen me dije se subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara etj.

Vërtetimi i pronësisë nr. 128, datë 19.11.2010, është ai i paraqitur në marrjen e lejes ndërtimore, pra nuk ka një KPP apo vërtetim pronësor të gjendjes aktuale të pasurisë si dhe nëse mbi këtë pronë janë vendosur shënime për masa të cilat kufizojnë të drejtën e pronarit mbi pasurinë, apo nëse ka pasur transaksione të cilat të kenë ndryshuar pronësinë.

-Objektin “Godinë Mikse, 2 kate tregtare, 6 kate banim dhe 1 kat përkimi në tokë”, ku është konstatuar se: Vërtetimi i pronësisë nr. 192, datë 10.10.2012, është ai i paraqitur në marrjen e lejes ndërtimore, pra nuk ka një KPP apo vërtetim pronësor të gjendjes aktuale të pasurisë si dhe nëse mbi këtë pronë janë vendosur shënime për masa të cilat kufizojnë të drejtën e pronarit mbi pasurinë, apo nëse ka pasur transaksione të cilat të kenë ndryshuar pronësinë.

Vërtetimi nr. 8449, datë 16.10.2015, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, nuk ka bërë konfirmimin e situacionit përfundimtar të punimeve, pra të pasqyrojë vlerën përfundimtare të objektit, pasi është kufizuar vetëm në bërjen me dije se subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara etj.

-Objektin “Ndërtesë 3kt shërbime”, ku është konstatuar se: Mungon Certifikata e pronësisë në emër të pronarit, si dhe Kopje të Kartelës mbi Pasurinë, (lëshuar brenda 3 muajve nga data e dhënies së lejes së përdorimit).

Vërtetim nga Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Kurbin lidhur me pagesën e detyrimeve për gjoba apo tarifa shërbimi, si dhe nuk është mbajtur korrespondencë zyrtare ndërmjet DPKZH dhe IMT.

-Në praktikat e **prokurimit të nevojave për karburant** të zhvilluara në vitin 2014 dhe vitin 2015, në kërkesat për kualifikim nga Njësia e Prokurimit nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin dokumentacion për punonjësit e siguruar, bilancet e pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme, shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë e qeverisjes vendore ku zhvillojnë veprimtarinë, etj; Mungon kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit; Mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit, specifikimeve teknike dhe fondit limit; Mungon miratimi i treguesve teknikë nga titullari i Bashkisë; Kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga Njësia e Prokurimit dhe jo nga specialisti i ngarkuar; Nuk është përcaktuar sasia e karburantit mbi bazën e mjeteve në dispozicion të Bashkisë dhe volumin e punës që parashikohet të realizohet; Nuk është evidentuar çmimi i karburantit i përdorur dhe marzhi i fitimit i marrë për bazë në llogaritjen e fondit limit.

-Për llogaritjen e çmimit të karburantit Njësia e Prokurimit është mjaftuar me të dhëna e buxhetit për karburant dhe nuk ka marrë për bazë të dhënat e botuara në buletin e APP të periudhës përkatëse për çmimet e karburantit të bursës sipas Reuters të datës kur u hartuan dokumentet e tenderit për kryerjen e prokurimit, si dhe nuk është bërë asnjë llogaritje se sa do të merret çmimi i karburantit për të llogaritur fondin limit. Pra për përcaktimin e çmimit të karburantit në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit.

Në dokumentet e tenderit, në përcaktimin e specifikimeve teknike nuk janë përcaktuar karakteristikat e mallit, treguesit kimikë e fizikë të tij dhe kërkesa e vërtetimit të tyre me analiza nga laboratorë të njohur për këtë qëllim, por thuhet “në përputhje me standardet në fuqi S SHEN 590:2013” pa i specifikuar, duke mos argumentuar fondin limit.

-Kanë hartuar dokumentet e tenderit me preventiv e specifikime teknike të pa miratuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe për mungesën e projektit e specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit në formatin elektronik, ku si rrjedhojë, është vepruar në kundërshtim me nenin 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët e standardeve të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

11. zj. M.H. me detyrë ish-Drejtoresh Juridike, për:

-Objektin në Pallatin e Kulturës “Lokal Bar- Bufë dhe lokal bodrum me lulishte”, nuk ka ndërmarrë të gjitha hapat ligjor e procedural për kërkimin e vlerës së qirasë nga subjekti ■■■■■, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016, duke sjellë për pasojë rritjen e vlerës të qirasë në shumën prej 6,673,140 lekë (qira dhe kamatëvonesa nga viti 2005 deri më 30.06.2011) dhe 4,377,744 lekë (2,721,600 lekë për 54 muaj nga data 01.07.2011 deri më 31.12.2015, si dhe kamatëvonesa për 1643 ditë, në shumën prej 1,656,144).

-Objektin “Çerdhe fëmijësh në katin e dytë” lidhur kontrata e qirasë nr. 858, datë 06.06.2014 dhe 2542, datë 07.12.2015, në shumën totale prej 241,200 lekë (24 muaj x 67 m²x150 lekë/m²). Pavarësisht pagesës rezulton se nga Bashkia Kurbin nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016, pasi kontrata nuk ka të bashkëlidhur asnjë dokument, si psh. Certifikatën e pronësisë, ku prona të jetë regjistruar në ZVRPP, Kopje të

Hartës Treguese të Regjistrimit, për identifikimin e objektit dhe sipërfaqes së tij, genplan të hartuar nga bashkia për objektin dhe të konfirmuar nga kryetari i saj, vendim të Këshillit Bashkiak për dhënien me qira të objektit, miratim të genplanit nga Prefekti i Qarkut Lezhë, etj, sipas përcaktimeve të Kreu II “*Procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore*”.

-Objektin “Tregu i fruta perimeve”, ku është lejuar subjekti të përdor sendin edhe pse kontrata e qirasë ka përfunduar prej vitit 2009; pagesa e shpenzimeve për energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm përballohet nga qiradhënësi dhe për rrjedhojë për gjithë periudhën e mësipërme, në kundërshtim me dispozitat ligjore për qiradhënien pagesa e energjisë elektrike dhe e ujit të shpenzuar nga tregu privat në qytetin e Laçit është likuiduar nga vetë institucioni pasi nga qiramarrësi nuk janë vendosur matësat e energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm dhe nuk janë lidhur kontratat me CEZ/OST dhe Ujësjellësin, veprime e mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016.

-Në tenderin me objekt “**Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra të qytetit të Laçit**”, nuk është argumentuar si është llogaritur norma ditore e punës për punimet që do të kryen dhe si është llogaritur sasia e materialeve që do të përdoren dhe cilat çmime janë marrë për bazë në llogaritjen e vlerës së materialeve, duke sjell për rrjedhojë fond limit të paargumentuar.

-Në praktikat e **prokurimit të nevojave për karburant** të zhvilluara në vitin 2014 dhe vitin 2015, në kërkesat për kualifikim nga Njësia e Prokurimit nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin dokumentacion për punonjësit e siguruar, bilancet e pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme, shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë e qeverisjes vendore ku zhvillojnë veprimtarinë, etj; Mungon kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit; Mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit, specifikimeve teknike dhe fondit limit; Mungon miratimi i treguesve teknikë nga titullari i Bashkisë; Kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga Njësia e Prokurimit dhe jo nga specialisti i ngarkuar; Nuk është përcaktuar sasia e karburantit mbi bazën e mjeteve në dispozicion të Bashkisë dhe volumin e punës që parashikohet të realizohet; Nuk është evidentuar çmimi i karburantit i përdorur dhe marzhi i fitimit i marrë për bazë në llogaritjen e fondit limit.

-Për llogaritjen e çmimit të karburantit Njësia e Prokurimit është mjaftuar me të dhëna e buxhetit për karburant dhe nuk ka marrë për bazë të dhënat e botuara në buletin e APP të periudhës përkatëse për çmimet e karburantit të bursës sipas Reuters të datës kur u hartuan dokumentet e tenderit për kryerjen e prokurimit, si dhe nuk është bërë asnjë llogaritje se sa do të merret çmimi i karburantit për të llogaritur fondin limit. Pra për përcaktimin e çmimit të karburantit në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit.

-Në dokumentet e tenderit, në përcaktimin e specifikimeve teknike nuk janë përcaktuar karakteristikat e mallit, treguesit kimikë e fizikë të tij dhe kërkesa e vërtetimit të tyre me analiza nga laboratorë të njohur për këtë qëllim, por thuhet “në përputhje me standardet në fuqi S SHEN 590:2013” pa i specifikuar, duke mos argumentuar fondin limit.

-Kanë hartuar dokumentet e tenderit me preventiv e specifikime teknike të pa miratuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe për mungesën e projektit e specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit në formatin elektronik, ku si rrjedhojë, është vepruar në kundërshtim me nenin 57 të

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe UMF nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët e standardeve të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

12. z. A.M. me detyrë Specialist inxhinier i Sektorit të Shërbimeve në cilësinë e anëtarit të NJHDT, pasi në tenderin me objekt “**Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra të qytetit të Laçit**”, në vlerën prej 37,711,115 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, [REDACTED] sh.p.k nuk është argumentuar si është llogaritur norma ditore e punës për punimet që do të kryen dhe si është llogaritur sasia e materialeve që do të përdoren dhe cilat çmime janë marrë për bazë në llogaritjen e vlerës së materialeve, duke sjell për rrjedhojë fond limit të paargumentuar.

13. z. V.G. me detyrë Specialist i Drejtorisë së Kontrollit dhe Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO dhe anëtarit të NJHDT.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt “**Ndriçimin e brendshëm të shesheve të lagjeve të qytetit të Laçit**”, në vlerën prej 1,248,648 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht Operatori ekonomik në regjistrin e ekstraktit historik të lëshuar nga QKR, në objektin e aktivitetit nuk ka të miratuar kryerje të punimeve në rrjetin elektrik; Puna e ngjashme e paraqitur është për instalime linja elektrike në shtëpi private dhe jo në sistem ndriçimi të një qyteti; Formulari i vlerësimit nuk është sipas formatit të shtojcës 8 të DST; Certifikatat e cilësisë së punimeve (ISO), janë në gjuhë të huaj dhe të pa përkthyer në gjuhën shqip, siç kërkohet në DST.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2015, me objekt “**Blerje materiale ndërtimi për sistemin e disa prej rrugëve të Lagjes nr. 5 (Sanxhak) Laç**”, në vlerën prej 2,280,000 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht Bilaci kontabël i vitit 2014 është i pa certifikuar nga organet kompetente Drejtoria Rajonale e tatimeve Lezhë; Kapaciteti teknik për furnizime të ngjashme operatori ekonomik ka paraqitur faturat tatimore për blerje betoni dhe hekuri në vitin 2013 dhe jo kontrata furnizimi me materialet e ndërtimit që prokurohen; Certifikatat e cilësisë ISO janë paraqitur në gjuhë të huaj dhe jo në gjuhën shqipe siç kërkohet në dokumentet e tenderit.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2015, me objekt “**Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve te varrezave 1+2+3, Laç**”, **Bashkia Laç**”, në vlerën prej 120,209,630 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi: Kriteret për kualifikim nuk janë bërë duke ruajtur parimin mbi trajtimin e barabartë, konkurrencën dhe mos diskriminimit. Kriteret e veçanta nga NJHDT janë të pa argumentuara, pajustificuara dhe të palogjikshme, pasi është vendosur si kriter: OE duhet të ketë në stafin e

tij të paktën 1 agronom i cili duhet të jetë i përfshirë në listëpagesën e operatorit ekonomik për një periudhë jo më të vogël se 3 vjet; OE duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 24 punonjës të siguruar për periudhën 2011-2013; Nuk është përcaktuar grafiku i shërbimit që përcakton dhe afatin e realizimit të kontratës; Janë marrë për referencë bazë preventivat për analizën e fondit limit në realizimin e këtij studimi, të cilat janë bërë pa një studim të tregut për nxjerrjen e fondit për secilin zë të shërbimeve që kërkohet të realizohet; Shërbimi është parashikuar të realizohet për një periudhë 5 vjeçare por pa asnjë argument perse është arritur në këtë rezultat.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt “**Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra të qytetit të Laçit**”, në vlerën prej 37,711,115 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht për vitin 2013 dhe muajin janar të vitit 2014 nuk ka plotësuar kërkesën për të pasur mesatarisht 12 punonjës të siguruar.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

14. zj. D.M. Përgjegjëse Finance në Ndërmarrjen Komunale, Kurbin në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

-Në praktikën e **prokurimit të nevojave për karburant** të zhvilluara në vitin 2014 dhe vitin 2015, në kërkesat për kualifikim nga Njësia e Prokurimit nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin dokumentacion për punonjësit e siguruar, bilancet e pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme, shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë e qeverisjes vendore ku zhvillojnë veprimtarinë, etj; Mungon kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit; Mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit, specifikimeve teknike dhe fondit limit; Mungon miratimi i treguesve teknikë nga titullari i Bashkisë; Kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga Njësia e Prokurimit dhe jo nga specialisti i ngarkuar; Nuk është përcaktuar sasia e karburantit mbi bazën e mjeteve në dispozicion të Bashkisë dhe volumin e punës që parashikohet të realizohet; Nuk është evidentuar çmimi i karburantit i përdorur dhe marzhi i fitimit i marrë për bazë në llogaritjen e fondit limit.

-Për llogaritjen e çmimit të karburantit Njësia e Prokurimit është mjaftuar me të dhëna e buxhetit për karburant dhe nuk ka marrë për bazë të dhënat e botuara në buletin e APP të periudhës përkatëse për çmimet e karburantit të bursës sipas Reuters të datës kur u hartuan dokumentet e tenderit për kryerjen e prokurimit, si dhe nuk është bërë asnjë llogaritje se sa do të merret çmimi i karburantit për të llogaritur fondin limit. Pra për përcaktimin e çmimit të karburantit në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit.

-Në dokumentet e tenderit, në përcaktimin e specifikimeve teknike nuk janë përcaktuar karakteristikat e mallit, treguesit kimikë e fizikë të tij dhe kërkesa e vërtetimit të tyre me analiza nga laboratorë të njohur për këtë qëllim, por thuhet “në përputhje me standardet në fuqi S SHEN 590:2013” pa i specifikuar, duke mos argumentuar fondin limit.

-Kanë hartuar dokumentet e tenderit me preventiv e specifikime teknike të pa miratuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe për mungesën e projektit e specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit në formatin elektronik, ku si rrjedhojë, është vepruar në kundërshtim me nenin 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe urdhrin e

Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët e standardeve të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2015, me objekt **“Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve te varrezave 1+2+3, Laç”, Bashkia Laç**”, në vlerën prej 120,209,630 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi: Kriteret për kualifikim nuk janë bërë duke ruajtur parimin mbi trajtimin e barabartë, konkurrencën dhe mos diskriminimit. Kriteret e veçanta nga NJHDT janë të pa argumentuara, pajustificuara dhe të palogjikshme, pasi është vendosur si kriter: OE duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 agronom i cili duhet të jetë i përfshirë në listëpagesën e operatorit ekonomik për një periudhë jo më të vogël se 3 vjet; OE duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 24 punonjës të siguruar për periudhën 2011-2013; Nuk është përcaktuar grafiku i shërbimit që përcakton dhe afatin e realizimit të kontratës; Janë marrë për referencë bazë preventivat për analizën e fondit limit në realizimin e këtij studimi, të cilat janë bërë pa një studim të tregut për nxjerrjen e fondit për secilin zë të shërbimeve që kërkohet të realizohet; Shërbimi është parashikuar të realizohet për një periudhë 5 vjeçare por pa asnjë argument perse është arritur në këtë rezultat.

15. z. S.LI. me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT).

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2015, me objekt **“Pastrimi i qytetit, ruajtja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve te varrezave 1+2+3, Laç”, Bashkia Laç**”, në vlerën prej 120,209,630 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi: Kriteret për kualifikim nuk janë bërë duke ruajtur parimin mbi trajtimin e barabartë, konkurrencën dhe mos diskriminimit. Kriteret e veçanta nga NJHDT janë të pa argumentuara, pajustificuara dhe të palogjikshme, pasi është vendosur si kriter: OE duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 agronom i cili duhet të jetë i përfshirë në listëpagesën e operatorit ekonomik për një periudhë jo më të vogël se 3 vjet; OE duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 24 punonjës të siguruar për periudhën 2011-2013; Nuk është përcaktuar grafiku i shërbimit që përcakton dhe afatin e realizimit të kontratës; Janë marrë për referencë bazë preventivat për analizën e fondit limit në realizimin e këtij studimi, të cilat janë bërë pa një studim të tregut për nxjerrjen e fondit për secilin zë të shërbimeve që kërkohet të realizohet; Shërbimi është parashikuar të realizohet për një periudhë 5 vjeçare por pa asnjë argument perse është arritur në këtë rezultat.

16. z. G.D. me detyrë NënKryetar i Bashkisë Kurbin dhe Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt **“Ndriçimin e brendshëm të shesheve të lagjeve të qytetit të Laçit”**, në vlerën prej 1,248,648 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht Operatori ekonomik në regjistrin e ekstraktit historik të lëshuar nga QKR, në objektin e aktivitetit nuk ka të miratuar kryerje të punimeve në rrjetin elektrik; Puna e ngjashme e paraqitur është për instalime linja elektrike në shtëpi private dhe jo në sistem ndriçimi të një qyteti; Formulari i vlerësimit nuk është sipas formatit të shtojcës 8 të DST; Certifikatat e cilësisë së punimeve (ISO), janë në gjuhë të huaj dhe të pa përkthyer në gjuhën shqip, siç kërkohet në DST.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2015, me objekt **“Blerje materiale ndërtimi për sistemin e disa prej rrugëve të Lagjes nr. 5 (Sanxhak) Laç”**, në vlerën prej 2,280,000 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht Bilaci kontabël i vitit 2014 është i pa certifikuar nga organet kompetente Drejtoria Rajonale e tatimeve Lezhë; Kapaciteti teknik për furnizime të ngjashme operatori ekonomik ka paraqitur faturat tatimore për blerje betoni dhe hekuri në vitin 2013 dhe jo kontrata furnizimi me materialet e ndërtimit që prokurohen; Certifikatat e cilësisë ISO janë paraqitur në gjuhë të huaj dhe jo në gjuhën shqipe siç kërkohet në dokumentet e tenderit.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt **“Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra të qytetit të Laçit”**, në vlerën prej 37,711,115 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht për vitin 2013 dhe muajin janar të vitit 2014 nuk ka plotësuar kërkesën për të pasur mesatarisht 12 punonjës të siguruar.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

D.MASA ADMINISTRATIVE

D/1.a-Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 45,46 dhe 47 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 14, datë 29.06.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Bazuar në shkronjën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 7 pika 2, 3/a ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, që në zbatim të neneve 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **7 anëtarët** e Komisionit Vlerësimit të Ofertave, *si më poshtë:*

I-Për ish-Komunën Fushë-Kuqe, 3 persona për 2 tendera, si më poshtë:

1 .zj. Gj.D. me detyrë ish-punonjës i Komunës Fushë-Kuqe në cilësinë e ish-Kryetares të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).

2. zj. Gj.U. me detyrë ish-punonjës i Komunës Fushë-Kuqe në cilësinë e anëtares së KVO.

3. z. K.V. me detyrë ish-punonjës i Komunës Fushë-Kuqe në cilësinë e anëtares së KVO.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt **“Blerje kazanë për grumbullim mbeturinash për Komunën Fushë Kuqe”**, në vlerën prej 1,333,000 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht nuk ka paraqitur dëshmi për punë të ngjashme, të dokumentuar me kontratë për furnizim me mallra, faturat tatimore për operacionet për shit/blerje mallrash, vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt **“Pastrimi i Territorit të Komunës Fushë Kuqe”**, në vlerën prej 2,063,380 lekë, ku është konstatuar se edhe pse ka marrë pjesë vetëm një operator pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht për makinën vetëshkarkuese me vinç është paraqitur vetëm kontrata e qirasë, pra mungon dokumenti i pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, dokumenti i kolaudit dhe leja e transportit nga organet e qeverisjes vendore.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

II. Për ish-Komunën Milot, 4 persona për 2 tendera, si më poshtë:

1. zj. R.K. me detyrë ish-punonjëse e Komunës Milot në cilësinë e ish-Kryetares të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).

2. z. A.B. me detyrë ish-punonjës i Komunës Milot në cilësinë e anëtares së KVO.

3. z. S.H. me detyrë ish-punonjës i Komunës Milot në cilësinë e anëtares së KVO.

4. zj. L.P. me detyrë ish-punonjëse e Komunës Milot në cilësinë e anëtares së KVO.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt **“Ndërtim fasade në qytetin Milot”**, në vlerën prej 2,147,250 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator, pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht: Mungon deklarata mbi gjendjen Gjyqësore, ku operatori ekonomik deklaroi nëse është i dënuar për shkelje penale në përputhje me nenin 45/1 të LPP, nëse nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës që lidhet me aktivitetin profesional; Mungon deklarata e përmbushjes së specifikimeve teknike; deklarata e konfliktit të interesit; deklarata e disponueshmërisë së mjeteve; deklarata e operatorit ekonomik që drejtuesi teknik i punimeve

do jetë në objekt i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet; Mungon leja e transportit e lëshuar nga njësitë vendore për mjetin vetëshkarkues deri në 3.5 ton; Për pajisjet teknike “Skeleri suvatimi” dhe “Kallëperi” nuk janë evidentuar sipërfaqet që disponon, por janë evidentuar në copë.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2014, me objekt **“Pastrim dhe transport i mbeturinave të qytetit Milot”**, në vlerën prej 2,500,000 lekë, në të cilin ka marrë pjesë vetëm një operator pasi nga shqyrtimi i dokumentacioni kualifikues të paraqitur në formatin elektronik, operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, e konkretisht: Mungon dokumenti i xhiros vjetore të realizuar në tre vite, kërkesë kjo e pikës 2.2. “Kapaciteti ekonomik”; Mungon kontrata me Spitalin Rajonal Lezhë, kërkesë kjo e dokumentimit të shërbimeve të ngjashme të realizuara më parë; Nuk përmbush kërkesën e dokumenteve të tenderit për numrin e punonjësve të siguruar; Mungon leja e qarkullimit dhe figuracioni për mjetin “Fshesë”; Mungon dokumentacioni zyrtar dhe i pronësisë për automjetin “Makinë Vinç”.

KVO, nuk ka bërë evidentimin e mangësive e për rrjedhojë nuk ka bërë as skualifikimin e operatorit ekonomik dhe anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim rishpalljen e tij, në kundërshtim me nenin 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

D.2 Për Inspektoratin e Mbrojtjes të Territorit, Bashkia Kurbin

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenet 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në proces verbalet nr. 3, 6, datë 27.06.2016 dhe 19 dhe 20 datë 30.06.2016 komentet e subjektit të audituar dhe pjesës takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit, pika 6 (faqe 112-145), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Kurbin t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë, për 3 mbikëqyrësit e punimeve dhe 4 kolaudator** punimesh, si më poshtë:

1. ing. F.B. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me *“Rikonstruksioni i kopshtit nr.1 në Bashkinë Laç (Dy Kate)”* Bashkia Kurbin, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 2,485,410 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

2. ing. L.L. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me *“Rikonstruksioni i kopshtit nr.1 në Bashkinë Laç (Dy Kate)”* Bashkia

Kurbin, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 2,485,410 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

3. ing. Ll.T. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me *“Ndërtim Kopsht Fëmijësh Milot”* Bashkia Kurbin, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 1,140,719 lekë pa tvsh për punime të pakryera dhe procedurën e zbatimit të kontratës me *“Ndërtim Ujësjetllësi Shullaz”* Bashkia Kurbin, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 2,490,330 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

4. ing. A.B. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me *“Ndërtim Kopsht Fëmijësh Milot”* Bashkia Kurbin, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 1,140,719 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

5. ing. E.N. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me *“Rikonstruksioni Shkollës nr. 2, Mamurras”* Bashkia Kurbin, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 2,147,844 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

6. ing. G.G. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me *“Rikonstruksioni Shkollës nr. 2, Mamurras”* Bashkia Kurbin, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 2,147,844 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

7. ing. P.G. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me *“Ndërtim Ujësjetllësi Shullaz”* Bashkia Kurbin, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën 2,490,330 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

Shënim: Për 19 punonjës, sipas listës trajtuar më poshtë, edhe pse kanë kryer shkelje apo parregullsi, duke qenë se për arsye të reformës territoriale kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me ish-Komunat Milot e Fushë-Kuqe apo ish-Bashkinë Mamurras e Laç, dhe nuk kanë adresim institucional, masat disiplinore konsiderohen të ezazuara, si më poshtë:

- 1.z. A.L. me detyrë me Ish-sekretar i Këshillit Bashkiak Laç
- 2.zj. M.N. ish-Sekretaren e Këshillit Bashkiak Mamurras,
3. zj. P.B. ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës Mamurras,
4. z. A.P. ish-Sekretar i këshillit Komunës Milot,
5. zj. F.N. ish-Përgjegjëse Finance Milot,
6. z. M.C. ish-sekretare e Këshillit Fushë-Kuqe,
7. zj. Gj.D. ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës, Fushë-Kuqe
8. zj. K.I. ish Specialiste dhe anëtare e KVO,
9. zj. E.S. ish Specialiste e Bashkisë Mamurras dhe anëtare e KVO,
10. zj. E.V. me detyrë ish-juriste Bashkisë Mamurras dhe anëtare e NJHDT,
11. z. N.C. me detyrë ish-Drejtori i DPKZHT dhe anëtar i NJHDT,
12. z. E.K. me detyrë ish-Drejtori i Financës dhe anëtar i NJHDT,
13. zj. R.P. Specialiste e Bashkisë Mamurras, DPKZHT dhe anëtar i NJHDT,

14. z. D.P. ish-Kryeinspektor i IMTV Bashkia Kurbin,
15. z. A.Gj. ish-Kryeinspektor i IMTV Bashkia Kurbin,
16. z. G.P. ish-Kryeinspektor i IMTV Bashkia Mamurras,
17. zj. J.M. me detyrë ish-Drejtori i DPKZHT Komuna Milot,
18. z B.A. ish-Përgjegjës i Zyrës së MMTP, Komuna Milot.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R